PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Mirëseerdhët në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak 24.09.2026. Faleminderit për pjesëmarrjen dhe Kryetarit bashkë me stafin.Do diskutojmë sipas rendit të ditës dhe në fund kemi atë pikën që të japim mendimin për reformën territoriale. Në atë moment zoti kryetar dhe përfaqësues të bashkisë do të largohen nga salla.Ftoj sekretarin të bëj apelin.

Elsid Zyma-Sekretri I Këshillit Bashkiak Elbasan

Bën apelin.Prezent në sallë janë 37 antarë.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Faleminderit. Nga 51 pjesëmarrjet janë 37 aktualisht.Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak me 30 vota pro, 4- kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(R.Mita)

V.K(L.Hasa,M.Kaculi,A.Mecja,E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika dytë e rendit të ditës

2.Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve datë 22.07.2026 dhe 13.08.2026.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 1- kundër, 8- abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(A.Domni,L.Hasa,M.Kaculi,A.Kana,D.Madhi,A.Mecja,A.Murati,R.Mita)

V.K(E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika tretë e rendit të ditës

3.Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi bashkisë për muajin gusht 2026

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, 1- kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(D.Madhi)

V.K(E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika katërt e rendit të ditës

4.Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar për muajin Gusht 2026

Këshilli Bashkiak me 34 vota pro, 1- kundër, 1- abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(D.Madhi)

V.K(E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika pestë e rendit të ditës

5.Mbi miratimin e formulës së pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social.

Zamir Muzhaqi-Zv.Kryetar I Këshillit Bashkiak Elbasan

E vetmja e vetmja gjë që diskutuam edhe në në komisione është që formulat e pikëzimit janë kritere të cilat vendosen nga VKM-të, kështu që nuk kemi çfarë të diskutojmë. Por e vetmja pikë ishte subvenioni i qerasë për qytetarët i cili është pothuajse jo realist me tregun imobiliar në qytet. Nuk e kuptoj se ku mund të gjendet më shtëpime nga 100.000 apo 120.000 lekë të vjetra në qytet, ndërkohë që tregu i imobilareve është në ngritje, kështu që e bëmë një pyetje aty, po nuk morëm sqarim që është detyrim, domethënë na është vendosur kjo shifër apo e ke e kemi ne në dorë këtë shifër ta vendosim si këshill bashkiak. se s'ma dhan përgjigjen.Sistemi i pikëzimit është në rregull.

Këshilli Bashkiak me 28 vota pro, 1- kundër, 8- abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(A.Domni,L.Hasa,A.Kana,D.Madhi,A.Mecja,R.Mita,A.Murati,Z.Muzhaqi)

V.K(E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkia

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika gjashtë e rendit të ditës

6.Për miratimin e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë dhe vlerën maksimale të subvencionit të qirasë për vitin 2027.

Gentian Dyrmishi-Përfaqësues nga Administata Bashkisë Elbasan

Atëherë sa i përket vlerës së subvencionimit që i përket për njësitë e banimit të cilat e kemi përcaktuar dhe te ky projekti ne si rregull i referohemi dhe faktit që bëjmë një testim dhe një studim në treg dhe mostrave të cilave ne i kemi marrë por edhe i referohmë dhe faktit të çmimeve referente për metër katror të cilat janë çmimet shtetërore dhe çmimet shtetërore për metër katror për njësitë e banimit akoma nuk janë rritur pritet që të rriten, por aktualisht janë në vlerën 50.300 m², mbi bazën e të cilës i referohet dhe çmimi i qerasë shtetërore për vlerë për metër. Kështu që është i njëjti çmim që është aplikuar pak a shumë si vjet i subvencionimit qerasë.Kështu që për aq kohë sa e kemi po të njëjtë të pandryshuar, jemi të detyruar ta zbatojmë po të njëjtin. Për 2027 bazë të një projektligji të cilit është edhe në konsultim sipër pritet që vlera për metër katror e çmimit për Elbasan referent të rritet dhe sigurisht nëse vitin tjetër do aplikojmë subvencionimin e qerasë e cila mund të jetë dhe me rregulla të tjera, patjetër do aplikohet edhe çmim më I lartë i subvencionimit qeras për njësitë e banimit sipas sipërfaqes së tyre.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Pyetja ishte specifike nga Zamiri dhe do të doja që t'i përgjigjeshit po aq specifikisht. Pyetja ishte, përpos atyre që janë përcaktimet ligjore për vlerën minimale apo maksimale të subvencionimit të qerasë, këshilli bashkiak dhe administrata e bashkisë, a kanë diçka në dorë që përpos specifikimeve ligjore ta rrisi këtë vlerë nëpërmjet përdorimit të fondeve të veta? Për shembull, keni juve lirshmërinë ta bëni diçka të tillë dhe ta miratojmë ne?Ka hapsirë ligjore?

Gentian Dyrmishi-Përfaqësues nga Administata Bashkisë Elbasan

Jo, hapësirë ligjore të mirëfilltë nuk ka, sepse ne do i përmbahemi dhe asaj që është parashikuar edhe në buxhet. Kështu që nuk edhe mund të nuk mund ta rrisim dhe mund ta vëmë sa të duam ose më sakt për metër katrore gjithmonë i referohet, referohet kritereve të tjera.
Kështu që thashë dhe njëherë në vitin e ardhshëm pritet që kjo të rritet edhe të rritet goxha dhe t'i afrohet dhe vlerës së tregut dhe atëherë do flasim me vlera dhe terma të tjerë kuptohet shumë më të larta.
Sigurisht edhe ne do duam që ta bëjmë të tillë.

Këshilli Bashkiak me 27 vota pro, 3- kundër, 7- abstenim, miraton sa më sipër.

V.A(B.Copja,A.Domni,L.Hasa,M.Kaculi,A.Kana,R.Mita,A.Murati)

V.K(D.Madhi,Z.Muzhaqi,E.Murataj)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma dhe Kryetari i Bashkisë Elbasan Gledian Llatja, anëtarë të KB, specialist dhe drejtorë nga administrata e bashkisë, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Të ndryshme:
1.Kalendari I Buxhetimit me pjesëmarrje mbi hartimin e buxhetit të vitit 2027.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

~~Faleminderit kryetar,faleminderit dhe ju përfaqësues të bashkisë.~~
Kjo nuk është me miratim ne bë parim unë thashë e keni të ndryshmet,ne kemi rënë dakord që të vendosim ca data dhe kjo nuk është fikse.Bashkia do të dali në terren bashkë me këshillin.

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

PROÇESVERBAL

I mbajtur sot më datë 24.09.2026, ora 17:00 në ambjentet e sallës së Këshillit Bashkiak Bashkia Elbasan , ku do të zhvillohet mbledhja e Këshilli Bashkiak me pjesëmarrjen e kryetarit të KB Z. Lutfi Lala, Zv. Kryetare Enerieta Ferra, Zv. Kryetare Z. Zamir Muzhaqi,Sekretari I Këshillit Bashkiak Z.Elsid Zyma anëtarë të KB, media.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pika 7 e rendit të ditës

7.Për dhënien e mendimit të Këshillit Bashkiak Elbasan mbi propozimin dhe riorganizimin administrativo-territorial.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Lidhur me mendimin e Këshillit Bashkiak Elbasan pro kundra apo dhe alternativë siç e kërkon dhe shkresa e ardhur nga Kuvendi.Ne si këshillë me të marrë njoftimin kemi ,shkresa përkatëse kemi bërë njoftimet publike për të bërë konsultimet me qytetarët e bashkisë. Eshtë si obligim dhe detyrim ishte që bashkia nëpërmjet administratorëve të organizonte takime të tilla domethënë për të dëgjuar, bërë dëgjesa. Meqënëse ne kemi dhe strukturën përkatëse pranë këshillit, vendosëm datat, caktuam orarin dhe ditën që do të zhvilloheshe këto dëgjesa, njoftimet janë bërë në faqen zyrtare të këshillit. Njoftimet kanë qenë dhe këshilltarët për të qenë të pranishëm në çdo mbledhje nëse do të ishin sipas dëshirë që kishin dhe mund t'ju them keni dhe për procesverbalet përkatëse nëpër dosjet mund të them që nga këto takime kanë marrë pjesë gati 670 qytetarë të cilët 513 janë shprehur pro dhe 76 janë shprehur jo. Pjesëmjarrja mund të ketë qenë dhe më e madhe, por ka pasur dhe nga ata që s'kanë dashur të firmosin dhe të shkruajnë. Sigurisht ka pasur diskutime dhe debate nga më të ndryshmet. Të gjitha ishin me sensin e saj që kjo reformë pothuajse është reforma territoriale e cila e cila mbyllet tashi me miratimin po ose jo në Kuvendin e Shqipërisë. Pas kësaj sigurisht nëse kalon do të ishte reforma e decentralizimit, gjë që neve si këshilltarë na përket dhe na intereson shumë që dhe ajo fazë të kishte një vëmendje shumë të rëndësishme nga bashkia, nga kuvendi dhe nga qeveria për t'i dhënë shumë më shumë kompetenca bashkisë dhe këshillave.Pra të gjitha këto sepse janë në fund të fundit janë në shërbim të qytetarëve.Siç jemi në dieni e të gjithë formula dhe propozimi është që Bashkia Elbasan, Bashkia Cerrik dhe Bashkia Belësh përbëhen në të ardhmen në një bashki e cila do të quhet bashkia Elbasan me qendrën në Elbasan, qytetin e Elbasanit.Do të kemi strukturën bashki, qytet, njësi, fshat,dhe detyrimisht ligjërisht ne na kërkohet një mendim qoftë pro qoftë kundra. Ne si komision atë ditë e kemi diskutuar bashkarisht që lidhur me mendimin të përqëndrohemi te tre grupet që

janë pjesë përbërëse e këshillit të japin nga një mendim të shkruajtur edhe ta dorëzojnë këtë shkresë , bashkë me vendimin që do të merret në këshill duhet të jenë dhe mendimet qofshin pro qofshin kundra do dorëzohen bashkarisht gjithë materialet përkatëse që ka. Kjo nuk do të thotë që do diskutojnë tre anëtarët e apo tre kryetarët e grupeve përkatëse sepse pas asaj fjala është e lirë për të gjithë anatrët e këshillit.

Zamir Muazhaqi-Zv.Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Bashkia Elbasan u mundua që të bënte disa konsultime publike meqë kryetari e filloi me këtë pikë e cila është shumë e rëndësishme dhe është një nga pikat të cilat e parashikon ligji.Por është po aq e vërtetë që në faqen zyrtare të bashkisë së Elbasan nuk ka pasur një njoftim për konsultim publik.Po kështu është po aq e vërtetë sa ky dielli që po na ndriçon tashi që nuk mund që një një bashki të madhe si Elbasanit me mbi 120.000 banor të marri vetëm nga 600 persona të cilët unë u pse janë 600 dhe jo 1400 sa keni sa keni juve punonjësit e bashkisë atë ditë unë kam qenë i pranishëm në konsultim, procedurën ti e fillove me konsultim edhe unë unë po të them për procedurë, me konsultim. Asnjë qytetar nuk ka qenë atë ditë. I gjithë ky grupi që u çua tani dhe iku, ai konsultim për faqen e zezë ka mbaruar me tre herë thirrjen rroftë Partia Socialiste.Pra unë atë konsultim publik nuk mund ta quaj.

Erion Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Pikë së pari kur jemi përballë një vendimi i cili nuk ndikon më thjesht bashkinë Elbasan,do duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe kur them shumë të kujdesshëm e kam fjalën për disa këtu në këtë sallë që kur vjen fushata elektorale i kujtojnë qytetarëve dhe kryesisht të majtëve luftën nacional çlirimtare. Cerriku për shembull është një bashki e cila përtej kontekstit historik, përtej faktit që ka shënjuar dhe te pjesa e Lançit që disa këtu e kanë shumë merak, është një bashki e cila ka specifikën e saj bujqësore dhe i vetmi argument që unë kam dëgjuar nga ligjbërësit shqiptarë deri sot, kryesisht Arbian Maznikut, ka qenë se çfarë problemi ka se deri dje quheshe filan fshati i filan kësaj krahine dhe sot do ta fshijmë fare këtë.Tani unë e kuptoj që kjo natyra postmoderniste e së majtës

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Cfarë po diskuton procedurë?Po ti po tregon historinë e Cerrikut nga bujqësia, ti po merresh me historikun e cerrikut, kur ta marrësh fjalën për të diskutuar thuaj çfarë të duash.

Erion Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Detyrohen sot të ngrejnë dorën që të shkrijnë tre bashki me një të re të lapsit.
Me i të rëndë të lapsit ti nuk mund t'i shrish dot tre bashki dhe unë po ju them vetëm kaq. Reflektohuni sa jeni në kohë.
Mos na çoni në shpërfaqe pastaj të gjërave që s'janë të hijshme për këtë këshill.

Hektor Ciftja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Ndryshe nga ç'mund të mendohet unë e gjykoj personalisht, dy fjalë i them personalisht pastaj do flas në emër të grupit që ne duhet të jemi krenarë që po bëjmë pjesë në një po bëjmë pjesë, në një pjesë të historisë së Shqipërisë që lidhet me shtet formimin ,grupi këshilltarëve socialistë rreth propozimit për reformën administrative territoriale dhe integrimin e bashkive Cërrik dhe Belësh në juridiksionin territorial e theksoj këtë të bashkisë Elbasan gjykon që ka këto konsiderata.Së pari, në mënyrë absolute pritet një përmirësim i koordinimeve dhe i shërbimeve publike.Në mënyrë absolute pritet të korrigjohen, të bëhen më mirë planifikimi i integruar i investimeve.Në mënyrë absolute pritet të formalizohet ajo që po ndodh, zhvillimi i bujqësisë në zonat rurale ku territoret e Elbasanit, Cërrikut dhe Belçit janë kanë një lidhje të rëndësishme në aspektin bujqësor dhe rural.Bashkëpunimi dhe planifikimi i përbashkët krijon mundësi për një qasje më të koordinuar progresive zhvilluese ndaj mbështetjes së fermerëve, përmirësimit të infrastrukturës bujqësore, ujitjes,kullimit,grumbullimit,promovimit të produkteve bujqësore, të gjithë aty ato gjëra që ka hall, ka merak të madh opozita kur kritikon të gjitha opozitat. Gjithashtu përvoja e shkëlqyer e bashkisë Elbasan në krijimin dhe funksionimin e strukturave që mbështesin zhvillim bujqësor është një bazë e mirë e asaj që ne e quajmë Bashki -Qytet që dhe mund të shërbejë si bazë për një administrim më të integruar të sektorit në territorin e ri.Pa diskutim që përfshirja në juridiksionin territorial të bashkive Cërrik, Belësh dhe Elbasan, potencial turistike do t'ju bënte edhe më funksionale dhe më të mëdha, më plotësuese, sepse përfshihen menaxhimi i burimeve natyrore, liqenet, pejsazhi, tradita, produktet lokale,elementet të trashëgimisë, një t territori i integruar do të mundesonte hartimin e një oferte turistike të përbashkët dhe krijimin e itinerareve që lidhin destinacione të ndryshme të zonës duke krijuar mundësi të mëdha për bizneset lokale dhe zhvillimin e ekonomisë së zonës.Absolutisht një pikë me rëndësi është konsolidimi i kapaciteteve administrative.Një gjë që e shohim dhe mund ta diskutojmë, mund ta komentojmë sa herë të duam.Absolutisht një përfitim shumë i madh është mundësitë më të mëdha për projekte, për aplikime për projekte dhe për financime. Është ndryshe të aplikosh për Elbasanin dhe ndryshe të përfshish në projektet dhe në aplikime Elbasanin,Cerrikun dhe Belsin në projekte të përbashkëta që mund të krijojnë një bazë shumë më të gjerë për aplikime dhe programe kombëtare evropiane dhe një raport shumë më të ndryshëm me donatorët, veçanërisht në fushat e infrastrukturës aq të rëndësishme, zhvillimit ekonomik, bujqësisë, turizmit, mjedisit dhe shërbimeve publike.Juridiksioni përfshira në juridiksionin territorial të bashkisë së Elbasan të bashkive Cërrik dhe Belësh thjesht bën realitet marrëdhëniet ekzistuese, formalizon marrëdhëniet ekzistuese ndërmjet territoreve ,formalizon aksesin e qytetarëve në shërbime dhe ruan aksesin e qytetarëve në shërbime dhe e përmirëson atë që në përfundim nga

vlerësimi më sipër grupi i këshilltarëve socialistë rezulton se riorganizimi territorial duhet të konsiderohet jo vetëm në aspektin e bashkimit administrativ të njësive vendore, por mbi të gjitha në funksion të organizimit më të mirë të territorit, përmirësimit të shërbimeve, planifikimit të investimeve, shfrytëzimit të potencialeve ekonomike,bujqësore, dhe turistike. Integrimi i bashkive Cërrik Belësh në bashkinë Elbasan, me bashkinë Elbasan, me bashkinë Elbasan, e theksoi këtë, me dhe jo në Elbasan, do të kërkonte një analizë të detajuar të kapaciteteve administrative, financiare dhe infrastrukturore. analizë që është bërë tashmë ë si dhe përcaktimin e mekanizmave që garantojnë vazhdimësinë dhe aksesueshmërinë e shërbimeve për të gjithë qytetarët dhe kjo është në rrugë dhe është bërë në këtë kuadër ne konsiderojmë të rëndësishme që në presin e shqyrtimit të riorganizimit administrativ territorial të merr në konsideratë ë kapacitetet administrative, nevojat e komuniteteve, potencial të përbashkëta ekonomike, turistike, planifikimi i investimeve dhe garantimi i shërbimeve publike pranë qytetarëve. Dhe duke u marrë këto në konsideratë që i përmenda dhe më lart dhe që janë tashmë të njohura nga të gjithë, sepse pavarësisht se këtu kërkohet me të drejtë që materiali të jetë më plotësues, materialet plotësuese janë në të gjithë diskutimet e bëra për reformën territoriale, sepse ne jemi njerëz politikë dhe i kemi lexuar. Ne do ta aprovojmë në tagrin tonë këtë lloj integrimi territorial dhe të bashkisë Cërrik,Belësh në juridiksionin territorial të Bashkisë Elbasan.Faleminderit.

Bianka Copja-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Përshëndetje të nderuar kolegë. Në fakt po na kërkohet sot mendimi për një reformë, por që në të vërtetë besoj nuk do të vlerësohet as qëndrimi, por thjesht kjo është një mbledhje formalitet.Nuk kemi përpara sot vetëm një propozim për të ndryshuar një hartë, por shtrimi një pyetje akoma më të madhe,si duam të organizohet territori ku jetojnë qytetarët tanë dhe mbi të gjitha kujt t'i shërbejë pushtetit vendor?Sepse një reformë territoriale nuk është thjesht bashkimi i disa numrave, sipërfaqeve apo njësive administrative.Pas çdo vije në hartë është një familje, është një fshat, është një qytet, është një histori, ka tradita, zakone dhe ka mënyrën e vetë të jetesës.Prandaj një reformë territoriale nuk mund të matet me sa bashki do të kemi.Duhet të matet mbi të gjitha me pyetjen e thjeshtë. A do të jetë qytetari më pranë apo më larg pushtetit vendor.Reforma e vitit 2014 nuk mund të trajtohet si një histori suksesi pa analizë,sepse u paraqit si një mënyrë për të rritur efiçencën, për të përmirësuar shërbimet dhe për të forcuar kapacitetet e pushtetit vendor. Sot përpara se të bëjmë një reformë tjetër duhet të kemi guximin të bëjmë bilancin e kësaj reforme,çfarë funksionoi, çfarë nuk funksionoi, sa kushtoi, çfarë shërbimesh u përmirësuan për këta qytetarë dhe mbi të gjitha çfarë çfarë përfitoi qytetarë nga kjo reformë e 2014-s? Do të thoja asgjë. Nuk mund të ndërtojmë një reformë të re mbi idenë se bashkia më e madhe është automatikisht më efikase. Një bashki mund të zgjerohet patjetër në hartë, por qytetari do të largohet nga administrata.Mund të rritet sipërfaqja, por të dobësohet

përfaqësimi.Prandaj sa të mëdha do t'i bëjnë bashkitë, sa funksionale do të bëjmë ato? Cerriku dhe Belshi nuk mund të trajtohen thjesht si pika në hartë. Atëhere dua të ndalem posaçërisht te Cerriku dhe Belshi. Po kemi histori të përbashkët, kemi marrëdhënie ekonomike,familjare, njerëzore, por lidhja nuk do të thotë identitet i njëjtë. Nuk mund të pranojmë që këto bashki të bëhen bashkë. Cerriku ka historinë e tij dhe zhvillimin e tij të veçantë lidhur me territorin e Shkumbinit, Belshi dhe Dumreja gjithashtu ka një karakter të veçantë territorial të lidhur me liqenet, ekonominë rurale, komunitetet e tyre. Edhe mënyra e jetesës, traditat, marrëdhënie shoqërore janë të ndryshme.Këto dallime nuk janë arsye për të ndërtuar ne mure, por janë arsye për t'i lënë ata të ekzistojnë në truallin e tyre. Bashkëpunimi nuk kërkon zhdukjen e identitetit. Dhe këtu vjen një problem tjetër. Nëse Cerriku dhe Belshi bashkohen me Elbasanin në një territor shumë më të madh, atëherë ka disa pyetje shumë konkrete që realisht nuk kemi marrë përgjigje as në diskutime edhe më të gjëra se këto. Çfarë do ndodhë me vetë qytetet e Cërrikut e Belshit? A do të mbeten thjesht qendra reale të zhvillimit? A do të kenë autonomi më reale administrative? A do të kenë investime të krahasueshme? Apo do zhdërrohen gradualisht në periferi të një qendre më të madhe administrative? Sepse rreziku nuk është vetëm humbja e një statuti të lartë. Rreziku është krijimi i një territori ku disa qendra bëhen gjithnjë e më qëndrore, disa të tjera gjithnjë e më periferike dhe mbi të gjitha ku është konsultimi real me qytetarët. E dimë shumë mirë që ato takime ishin një farë siç e tha dhe kolegu Zamir, ishin takime të mbushura me administrate dhe punonjës të tjerë, jo me qytetarët realë për të marrë vendimin ata se çfarë duan. Realisht ato kanë folur dhe kanë qenë kundra bashkimit.Nëse objektivi tjetër është decentralizimi, atëherë duhet të flasim për më shumë kompetenca, më shumë autonomi financiare, më shumë përgjegjësi, më shumë transparencë. Nuk mund të kemi bashki më të mëdha dhe pushtet më të centralizuar.Qëndrimi besoj është i qartë kundër bashkimit të bashkisë së Elbasan me bashkinë Cerrik dhe Belësh. Dhe jo vetëm kaq, ne propozojmë që Cerriku dhe Belçi të vijojnë të jenë bashki më vete me identitetin, administrimin dhe zhvillimin e tyre territorial, por njëkohësisht në diskutim për konfigurimin e ardhshëm në territorit të Elbasanit duhet të shqyrtohet edhe një alternativë tjetër, bashkia e Shpatit dhe bashkia e Bradasheshit. Kjo nuk duhet të vendoset mbi bazën e interesave politike, por të lidhjeve historike, territoriale, ekonomike dhe shërbimeve publike. Dhe realisht cili nga këto konfigurime i shërben më shumë qytetarë dhe jo hartës politike tuajës. Dhe dua ta mbyll me një mesazh real për reformën tuaj territoriale të 2014-s me premtim do të cilë më shumë efiçencë shërbime, por nuk solli asgjë për qytetarët dhe shpopullimi vazhdon edhe sot. Nëse nuk e kemi bërë këtë bilanc se çfarë ndodhi atëhere nuk kemi se si të vazhdojmë me këtë reformë të re që na servirni. Nuk kemi analizat e duhura ekonomike dhe sociale dhe nëse qytetari nuk është në qendër të reformës atëherë kemi ndryshuar hartën po jo problemin thelbësor. Prandaj Elbasani nuk ka nevojë për një hartë më të madhe. Elbasani ka nevojë për një pushtet vendor më funksional, më të decentralizuar dhe më pranë qytetarit dhe Cerriku dhe Belshi nuk mund të humbasin identitetin e tyre për t'u administruar më mirë.Bashkëpunim

patjetër që po, por bashkim i detyruar jo. Si territor mund të bashkohet thjesht me një vijë në hartë,por jo identiteti i këtyre qyteteve më vete. Për një komunitet nuk duhet fshirë historia, traditat dhe identiteti i tij kryesor. Faleminderit.

Doris Madhi-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Në fakt ju zoti Lala në mbledhjen e komisioneve na kërkuat edhe një relacion të shkruar. Nuk është se nuk u mundova ta bëj, po u emocionova aq shumë negativisht sa kisha frikë që kur ta dorëzoja do ma nxinin të gjithë edhe nuk do depozitohej në këshillë. Në fakt sa herë që merren vendime kaq të rëndësishme dhe unë po i referohem fjalës profesorit që tha kemi mundësinë të marrim pjesë në një moment shtetformimi, fatkeqësisht do ta kundërshtoj dhe do t'i them ne po marrim pjesë në një moment shtetshkatërrimi dhe nuk është hera e parë kjo dhe nuk është hera e parë që ca bëhen palë e ca të tjerë nuk kanë mundësinë reale që ta kundërshtojnë këtë. Nuk është vetëm bashkia e Cerrikut dhe Belshit apo dhe ajo e Prenjasit që nuk u përmend këtu sepse ato tashmë e kanë votuar kundër.Por nuk është vetëm ky problemi. Problemi është edhe për Elbasanin.T'i flasim realisht qytetarëve se si i prek ky bashkimi.Në fakt këto relacionet që na keni dorëzuar që nuk janë fare të detajuara ashtu siç duhet të ishin,na keni thënë diku që bashkia Cerrik është një bashki problematike që nuk meriton më të jetë bashki për shkak të mungesës së popullsisë, për shkak të mungesës së urbanizimit, por mbi të gjitha për shkak të detyrimeve shumë të rënda, barrës fiskale shumë të rëndë dhe borxhit shumë të rëndë që kanë kurriz të prapambetur.Tani e para punës të mbledhi mendjen ky kryeministri juaj se ish-kryebashkiakun e promovoi, e bëri ministër. Kështu që pse paska qenë kaq e keqe dhe kaq e keqmenaxhuar kjo bashkia? E para. E dyta,i them qytetarëve të Elbasanit dhe juve që jetoni këtu në Elbasan, çfarë taksirati kemi ne të paguajmë borxhet e Cerrikut? Jo për gjë po s'kemi paguar tonat akoma kemi dhe ne. Nëse do të doja një përgjigje nga ju, duhet ta gjeja te ky relacioni. Kush do ishte përgjigja që duhet të më jepnit ju mua? Zonjë, buxheti i Elbasanit bashkë me Cerrikun dhe Belshin do 10 fishohet, do bëhen një, dy, tre, katër, pesë investime të mëdhaja në konsolidim.Por ju nëpërmjet kësaj reforme dhe këtij relacioni që na keni sjellë, tregoni vetëm që doni të shuani territore, doni t'i largoni shërbimin qytetarit. E dini ju që Kajani është më afër urës vajgurore sesa Elbasanit? Do vijë një qytetar nga Kajani për një copë letre dhe do degdiset derëve të bashkisë dyerve të bashkisë së Elbasanit.
Sa do shtohet numri i punonjësve këtu? Sa punonjës do hiqni nga puna në Belsh dhe në Cerrik? Sa investimet do t'i hiqni pastaj Belshit dhe Cerrikut se do vijnë, do jetojnë në Elbasan ato? Pyetja tjetër është, çfarë plani keni bërë me Belshin? Se që ja keni bërë plan e kam shumë të qartë.Belshi është një zonë super e bukur me potencial turistik, do ta shpopulloni, do bëni resorte, do bëni një grin kost të ri dhe do t'i hiqni çdo gjë që ka sot, se po të jetë për të bashkuar territore, për t'i bërë bashkë, më shumë meriton Belshi sot të jetë kryeqendra jonë, se s'ka një rrugë të pashtruar. Ndërsa ne sa dalim nga shtëpia bem nëpër gropa,

ne na plas ujë rrugëve,nuk ka pasur Belshi nga këto probleme ndonjëherë të paktën këto vitet e fundit që e kemi në fokus. Jo.Pra juve që të jenë të qartë dhe qytetarët keni vetëm një qëllim. Sa herë që bëni reforma dhe çuditërisht i bëni kur afrohet viti zgjedhor elektoral,ju keni një qëllim, të bashkoni votat e majta dhe fatkeqësisht e dimë të gjithë, sepse të gjithë jemi marrë me fushata që përqindjet më të madhe të votave majtas i merrni pikërisht në këto zona dhe të gjendur në situatën e menderosur në të cilën jeni sot që ju ka dalë çdo gjë sheshit përfshirë dhe të brend brshmet sigurisht që ju duhet të konsolidoni territore, buxhete, borxhe, por ju duhet të konsolidoni votat dhe kjo është arsyeja sepse po bëhet një reformë e re territoriale pa numra, pa shifra, pa buxhete, pa përllogaritje efektesh. Po bëhet një reformë territoriale që numra konsideron njerëzit dhe meqë ra fjala te numrat, ato personat që janë shprehur pro kësaj reformës që nuk po i hyj më se kush ishte, janë nga llogaritë e mia vetëm 02% e përfaqësisë së gjithë popullsisë së tre qyteteve, çka do të thotë që këto konsultimet e kanë vlerën zero. nuk mund të mblidhet 02% e popullsisë dhe të vendosi për të gjithë të tjerët dhe sa herë që bëhet reforma qendra duhet të jetë qytetari. Në fakt qytetari është edhe një herë tjetër i përdoruri në këtë mes.Dordoleci në këtë mes që vjen, bën sikur shpreh mendimin dhe ikën në shtëpi. Kjo gjë, të dashur qytetarë, këtë e kam me qytetarët e Elbasanit, Cerrikut dhe të Belshit është diçka që është vendosur paraprakisht që në momentin që u ngrit dikush pa një ëndërr dhe bëri pesë llogari votash. Sot qytetarëve të Elbasanit i takonte të ishin atje poshtë ose të Cerrikut e të Belshit nëse nuk e donin këtë. Sot qytetarët nuk janë këtu. Sot prapë po ngrejmë zërin ne që duhet ta them, jam në fund të mandatit, po do ta them dhe nuk do bëhem fare pishman për këtë. Qytetarët kanë tradhëtuar opozitën, por mbi të gjitha qytetarët kanë tradhëtuar veten me këtë sjellje. Ndaj Cerrikut, Belshit e kush tjetër që do përfshihet këtu, po jua them me gjithë luftën që kanë bërë në këtë këshillë, shumë mirë t'jua bëjnë. Faleminderit.

Altin Mecja-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Unë jo vetëm që shprehem vetë kundra, po i them dhe miqve të mi, qofshin majtas apo djathtas, të shprehen kundra për shumë arsye. E para njëherë do largoj votuesin në zgjedhjet e pjesme që kishim Lutfi 15% votuan.E kam thënë dhe një herë tjetër do vijë momenti që majtas dhe djathtas e establishmentit tonë përfshi dhe mua nuk do na japin dorën njerëzit ma me na votu. Problemi është se votojmë me mendje Lutfi dhe ju të tjerët sepse neve nuk na ka kush na fik radarin.Po pse jam unë kundra?E para herë katunët në qendra kaq të mëdhaja harrohen,largohet shërbimi. Tjetra është ekziston rreziku i përqëndrimit. Edhe unë të jem kryetar bashkie do merrem me qendrën, nuk do merrem me fundin e arër siç ne e kemi zakon Lutfi që i rregullojmë dhomën kryesore pastaj të tjerat me radhë. Humbet identiteti lokal. Nuk e di se ku i themi Shmil, Darësi, Dumre, Sulovë, Shpatë, Shushicë apo katunin tim.Dobëson edhe rrezikon centralizimin sepse e gjithë loja di për çfarë bëhet, që gjithçka të kontrollohet. Se sa më e madhe të jetë gjëja, aq më e kontrollueshme është,se kur është më e vogël ka më shumë pluralizëm. Ashtu siç edhe ti nga partia tënde ka pas s'ka pasur qejf njeri. Po i mundje. Dakord? Por unë

e shoh që këto duan që të boshatisin Belshin. Po e them mbase më të dukem më vonë si një orakull i Delfit.Belshin do e marrin çufot, Izraelitët nuk kanë ata pse vijnë në shmil e në polis. Kjo ka nevojë dhe për një reformë zgjedhore duhen lista të hapme që secili të fitojë ai që merr votat. Jo kush kandidat ka fut njerëz e vet apo kush kryetar partie. S'dua unë të jem në avenirin e asnjë kryetari qofsh të madh Tiranë të vogël në Elbasan.Përkundrazi, kryetarët e njësive administrative duhen me votë që të garantohet një farë pluralizmi.Pavarësisht se kush e merr bashkinë kryesore, mund të kemi 10 apo 15 kryetarë njësish të zgjedhur me votë.Të votojmë si njerëz.Faleminderit.

Erion Murataj-Anëtar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Tani unë nuk do dua të zgjatem shumë.e nisa më parë, po ti më ndërpreve se sa herë ju përmend juve lançin,kafshoni gjuhën se e dini që e keni përdhosur sakrificën, nderin, gjakun e tyre.E në fakt kolegët folën shumë, disa hynë dhe në detaje, por është fakt që fshatrat e Elbasanit janë braktisur.Ti Lutfi ke qenë kryetar komune dikur dhe interesi edhe meskin po themi i një njeriu politik është t'i shërbejë që t'i marri votën në fund fare. Kështu e keni katandisur juve në 35 vite Shqipërinë dhe okay është ajo punë. Në rregull.Mirëpo kur shkërputesh normalisht që kur vjen në Elbasan dhe e shikon me dylbi Shushicën, normalisht që dajakun e ha Lutfiu pastaj si përfaqësuesi politik i zonës. Po unë s'jam parim m po bëj diskutimin tim. Nuk e nuk e ndalon dot ti. Kështu që mbaje vendin që ke. Nuk do mend pastaj që lindin mekanizma që dhe pse është Lutfiu ose një emër tjetër diku në një zonë të caktuar çohet me trampolinë një anonim tjetër për të bërë administratorin.E kjo në fund fare përkthehet në atë ofshamën e çdo qytetari të Elbasanit që e thotë, që e shkruan, që e flet, por që nuk del dot t'jua përplasi turinjëve ju.E sot në fakt kemi ardhur te dita që pasi zhbët identitetin krahinor, pasi të rinjëve i pamundësuat krenarinë për gjyshërit, por i kthyet në kavje Tiktoku dhe Instagrami pasi i zbët komplet respektin për arsimin atë atje në komunë ku mësues komunës shpesh herë nga vetë komuniteti. Sot i keni çuar pjeshka partie.që padyshim nuk e kanë mendjen t'i mësojnë fëmijët. Sot prodhuat dhe kur them prodhuat e bashkëprodhuat PD dhe PS sot juve mbasi dështuat me reformën e 2014-s duke sjellë me katapultë emra si puna ky këtij tipit që kemi kryetar bashkie këtu në Elbasan me bekimin e të parit gjendemi përpara faktit që Elbasani është bjerrur s'ka më studentë Elbasani është shkatërruar, infrastrukturën e ka cop cop, bën dhjetra milionë euro investim në ujësjellës, nuk ka ujë në çezma.Dhe vini sot dhe më thoni që duam të bëjmë reformë.Ju në fakt nuk doni të bëni reformë. Ju po i jepni kazmën e fundit ose më sakt para fundit, se të fundit keni plan t'ia jepni kur në ëndërrat tuaja me Gysin. Përfaqësimin politik e keni deri te drejtuesja e shërbimit informativ. E çoni të ulos them ndonjë gjë tjetër përpara një pseudo biznesmeni.Kjo është reforma që bëni juve. Pra reforma e ministrave që kur t'i shikoni në videot që do dalin do ju vijë turp nga vetja që keni dhënë dorën. Disave nga juve mb si vjen turp e keni me qejf atë punë sot juve. Po po po e ruaj unë, po e ruaj shumë etikën. Sot juve po tentoni t'i jepni shkelmin.Personalisht me sa kam

unë mundësi do t'jua pamundësoj këtë gjë.Do t'jua pamundësoj sepse unë dua që fëmijën tim të rrisë këtu. Sepse unë dua që nenës nderimet e fundit t'ja bëj këtu. Edhe palaço politik si ata të Tiranës që sjellin reforma,me USB nuk e ndalojnë dot këtë gjë. E në qoftë se ju keni plan të ktheheni në kohën e pash Toptanit, dijeni që do ju dali përballë ndonjën Avni Rustem.Dhe sot po ju them për herë të fundit, mos e bëni gabimin ta votoni këtë pseudo reformë sepse një nga armiqt kryesorë e keni në këtë sallë.

Valbona Balliu-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

Të nderuar kolegë, i nderuar zoti kryetar, pik së pari afro 25.000 vetë, 25.000 qytetarë,të Belshit dhe 17.000 të Cërrikut, afro 40.000 qytetarë përfaqësohen me një paçavure si kjo.Tani kjo është fyerje për të gjithë ne këtu të majtë e djathtë. Sado të partis të jeni, gjithsesi secili nga ju ka nje integritet profesional dhe personal.Do dëshironte që të kishte të paktën një dokumentacion më korrekt, më të plotë, sepse vota e këtyre dhe e jona gjithashtu është vendimtare.Ata mund ta kalojnë, por gjithsesi duhet të kalojë patjetër në çdo këshill bashkiak.Më vjen shumë keq në radhë të parë për 14 deputetët e qarkut Elbasan, të cilët duhet të ishin sot se janë përfaqësues të atyre fshatrave Cërrikut, Belshit dhe Elbasanit dhe si qendra doja që gjithsesi kishin qenë prezentë këtu për të mbrojtur dhe ata këndvështrimin e tyre, se beteja e tyre vërtetë është parlamenti, por votat e qytetarëve të Elbasanit kanë marrë.Gjëja tjetër më bëri përshtypje se kam dhe profesorin tim këtu ky Cërriki, aq serioz është kjo shkresë. Aq serioze është kjo shkresë. Ky shkrim sa dhe as chatGPT e ka redaktuar Cërriki dhe më bëri dhe një gjë tjetër përshtypje,njësia e re pasardhëse universale e bashkive që konsolidohen. Bashkia që do bëhet do jetë universale. E kuptoni se sa përpara kemi ec.Gjëja tjetër, meqënëse të gjithë e dimë që kjo reformë do kalojë, se kryeministri ynë rilindas ka ecur në atë devizën e Sami Frashrit, se profesori e di Shqipëria ç'ka qenë, çështë dhe çdo të bëhet, e ka parashikuar dhe Belshin si kryeqytetin e Shqipërisë.e meriton në fakt një qytet pa çabure siç është bërë Elbasani me rrugë të pashtruara me kanalizimet jo te sistemuara e me 100 problematika që janë thënë e stërthënë këtë këshillë të paktën Belshi ka një pamje estetike dhe natyrore dhe infrastrukturore ka një çik më më elegante për të qenë plus për zotërinë vend sa të duash t'i ndërtoni buzë liqeneve qysh doje bardha zemër do bëhet kjo sepse po ky burri e ka parashikuar dhe atë shtetin e thellë e bektashi të cilin kryeministri ynë rilindas po e realizon 100 vjet më vonë mos ju duket çudi që nesër kjo godina këtu të kthehet te ai ndërmarrje ose të jepet me PPP edhe ta keni bashkinë Belsh? Po për nhë gjë më vjen mirë për gjithë ato Elbasanlli që janë këtu s'ka katunar ma as katunar Belshi, as katunar Cërriku, jemi të gjithë Elbasanlli. Për këtë më vjen mirë që nga pikëpamja e stigmatizimit social dhe shoqëror u bëmë të gjithë të barabartë. Ju falemindërit.

Ergys Muzhaqi-Anëtar I Këshillit Bashkika Elbasan

Unë nuk mund të rrija pa i thënë dy fjalë dhe përpiqem ta përkufizoj shkurt idenë time përgjithësisht edhe i përshëndes parafolësit sepse që të gjithë kanë kapur elemente shumë të vërteta, shumë të sakta, qoftë parimore, qoftë teknike të nevojës që kemi për të mos ta votuar, pro për të mos ta mbështetur këtë reformë të propozuar. Mund të ofrojë një këndvështrim tjetër. Pra, përveç buxheteve që nuk funksionojnë dhe janë të dukshëm jofunksional edhe pastaj si do funksionojnë po të shtosh edhe hapësira të tjera. Përveç me të vërtetë një relacioni që nuk pasqyron asgjë nga ajo që duhet të pasqyronte për sa i përket bisedës me popullsinë e interesuar për këtë reformë. Këtu kemi gjithë ajo zonë e Gjinarit me 25 vetë, gjithë ajo zonë e Zavalinës me 30 vetë, gjithë ajo zonën e Treganit me 32 vetë sa ishin. Domethënë kaq kanë marrë pjesë aty dhe këto kanë qenë të thirrur nga partia në pushtet se kemi qenë edhe i kemi parë shumicën. Elbasan ndoshta ndryshoi diçka në qytet, por jo thelbësisht. Pra të gjitha këto qëndrojnë. Po shiko, sepse ne duhet ta kuptojmë ndoshta edhe nga një kornizë më e gjerë, më gjithëpërfshirëse situatën në të cilën ndodhemi dhe pse vjen ky propozim edhe çfarë mund të shkaktojë.Në parim ne duhet të jemi të vetëdijshëm edhe t'ia themi njerëzve që na njohin edhe na kanë votuar edhe na ndjekin që ne jemi dëshmitarë se si të gjitha punët në shtetin tonë po shkojnë drejt një centralizimi që të çon drejt një autokracie paradiktatoriale. Kjo është e qartë. Pse sot nuk ka më leje ndërtimi që jepen nga njësitë vendore janë centralizuar. Sot nuk ka tendra që secili dikaster ndërmarrje apo organizim qeveritar t'i bëjë sipas interesave të tij. Jo, do jenë të gjithë centralizuar. Ne jemi të vetëdijshëm që ka dhe plane të tjera për centralizime të tjerëve sektorë jetik për shoqërinë tonë.Dhe tashi kjo është hapi i radhës goxha i rëndë për centralizimin edhe të kompetencave vendore edhe të le të themi hapësirave për veprim të njerëzve në vendet ku ato banojnë edhe jetojnë dhe ushtrojnë aktivitetet e tyre, ndërtojnë jetën e tyre, ngrejnë familjet e tyre. Edhe kjo përtej aspekteve kulturore që ne i kemi, pasurisë e kemi treva me larmi kulturore të cilat ja kanë arritur me i ruajt vetë. vlerat e tyre. Edhe kjo është një gjë tjetër që thotë centralizim.Pa dshim që ë ka dhe elementin politik të cilin duhet ta përmendim patjetër që është më lehtë për t'u menaxhuar një kandidat për një zonë të gjerë, për t'u fituar ai dhe për t'u kontrolluar më vonë në komunikimet politike, partiake, qeveritare sesa me pas variacione të ndryshme në zona të ndryshme. Edhe kjo është e tillë. nuk mund të jemi dakort pra me një situatë të tillë e cila nuk është testuar. Pra duhet ta kemi parasysh që kjo është një situatë e patestuar.
Sikur vetëm kaq të kishte bërë Partia Socialiste ose më mirë se nuk e them dot Partia Socialiste, se njoh shumë socialistë që nuk përfaqësohen me Edi Ramën edhe klikën e tij, kultin e tij të rilindjes. Sikur vetëm një zonë pilot të ishte bërë në Shqipëri një zonë pilot e cila edhe sikur të ndryshojë qeveria, edhe sikur të ndryshoje bashkia, bashkia jona, bashkitë e tjera, sikur të ndryshoje domethënë konfigurimi politik që kemi sot, të lindte diçka të qëndësishme dhe të qëndrueshme. Pra merret një zone pilot, testohet ajo zona pilot me iliciacion të veçantë, të ngjashëm me këtë që synoni të miratoheni sot këtu

edhe nesër në në parlamentin e Tiranës edhe pastaj të shikoshim pr edhe kundërt edhe fundi i fundit dhe ne si opozitë po ta shikonim pozitive do thoshim bravo e qoftë paska qenë e mirë leje të vazhdojë. As kjo nuk është bërë pra nuk është se po bëjmë histori këtu këtu po prishim histori. Asnjë elementempirik,politik,ekonomik, social nuk funksionon në këtë gjë,dhe e ndjej për detyrë t'ia them qytetarit, fshatarit që më njeh më voton. Mua që njeh voton kolegun tim ë mikun bashkë udhëtarin tim në në këto vite të këshillit bashkiak. Përndryshe e dimë,e keni votën, gomarin e Nastradinit e keni shalu për smrapthi.Duken gjërat që dhe krimin e organizuar e keni centralizuar. Edhe me atë do merret vetëm një njeri që ka qëlluar dashi im. Nuk merren dot të gjithë siç merreshin më përpara në fillimet e qeverisjes socialiste. Pra ky është një qëndrim i qart imi kundër në mbështetje edhe të kolegëve të mi edhe deklaratës, kryetares së grupit. Qytetarët me sa duket nuk kanë asnjë fjalë në këtë rast.

Lumturi Hasa-Anëtare e Këshillit Bashkiak Elbasan

I nderuar kryetarë, të nderuar kolegë, po flasim dhe po presim për këtë reformë administrative territoriale për të dhënë mendimin gjithse nga ne.
Të gjithë flasim me mençuri dhe përderisa mendojmë që është historia e dikujt tjetër, është historia e atyre qytetarëve aty.Po kush jemi ne radhë të parë që të japim mendimin pa i dëgjuar ato qytetarë, qytetarët e Cerrikut, Belshit,Kajanit, Grekanit apo të gjithë ato njerëz. Me sa di unë, Bashkia e Elbasan sot ka vështirësi të menaxhojë siç duhet territorin që ka. Mjafton të shohim gjendjen e rrugicave, pallateve, lagjeve dhe lagjeve të periferisë për ujin e pijshëm, për problematikat e ujësjellësit, dhe mos flasim më tepër.Atëherë si mendojmë se do të menaxhojmë territore edhe më të largta?Të zgjerosh territorin pa rritur kapacitetin e shërbimeve nuk është zhvillim,rrezikon të sjellë më shumë problematika, më pak shërbim dhe më shumë largësi mes qytetarëve dhe pushtetit vendor. Unë e shoh si rrezik dhe si një mënyrë për ta lënë Belshin dhe Cerrikun mënjanë duke i zhdukur dhe duke i larguar se duke i bashkuar unë nuk e di se si do ta menaxhojnë këto që do punojnë këtu për të parë dhe për të verifikuar problematikat në ato zona aq të largta. A e mendoni ju se çfarë jemi ne duke dhënë një mendim kur ato të tjerë atje protestojnë dhe nuk e duam bashkimin e këtyre bashkive?Thjesht kjo i shton dhe i bashkon problemet dhe i shtrin në një territor akoma dhe më të madh. Dhe kam një pyetje tjetër. A mendoni vërtetë se e gjithë kjo administratë aktuale është në gjendje ta menaxhojë?Dhe një territor ka nevojë për një pushtet lokal të përfaqësuar nga njerëz që e njohin atë zonë, jetojnë në atë zonë dhe i dinë problemet ndaj asaj zone. Dhe nuk është mirë që të jemi të gjithë këtu dhe të ngrejmë atë kartonin a priori, të marrim atë rrogën 250.000 lekshe dhe të ikim të zhdukemi nga problemet e qytetarëve, sepse jemi të zgjedhur të gjithë këtu jemi të zgjedhur nga ato qytetarë. Unë jam kundra bashkimit të këtyre bashkëve.

Artan Kana-Anëtar I Këshillit Bashkiak Elbasan

Kisha dhe unë dy fjalë pa u zgjatur pak a shumë kolegët e mi ezauruan gjithçka, por nuk bie absolutisht dakort për atë që tha zoti Hektor që po bëhemi pjesë e historisë.Ndoshta po bëheni pjesë e historisë, por po bëheni nga e kundërta tradhëtisë së këtij vendi.Kjo reformë është kryekëputë shpopullimi final i këtij vendi.Po ju sjell vetëm disa fakte që janë tamam janë tashmë të dukshme prej reformës që ju ndërmorët në 2014 dhe implementuat në 2015 Çfarë ndodhi? Zmadhuat me gjithë me të vërtetë bashkinë Elbasan apo dhe shumë bashki të tjera. Por çfarë ndodhi? U largua shërbimi nga qytetarët dhe nga zonat.Nëse ti i heq qytetarit shërbimin, atëherë ai nuk ka motiv që të rri më në atë zonë. Kështu ju shpërbët dhe shpopulluat një pjesë të madhe të popullsisë me planin ogurzi që po ndodh të paketës maleve dhe shumë planeve të tjera që ne nuk i dime. Prandaj dhe për ta ilustruar këtë më mirë, shembulli më i mirë është Elbasani.Elbasani para reformës territoriale na thuaj që kishte probleme, se nuk kishte financa, sepse bashk ajo komuna e Bradasheshit merrte të gjithë të ardhurat e metalurgjikut, zonës industriale dhe kështu me këtë argument edhe unë në atë kohë u binda që ishte e mirë që të zmadhohej bashkia dhe vërtetë me bashkimin e shumë komunave dhe ish me një fjalë sot ishkomuna në bashkinë e Elbasanit dhe përqëndrimin e të gjithë pushtetit vendor në bashkinë e Elbasanit u rritën të ardhurat. Por çfarë ndodhi? A u rrit mirëqenia e qytetarëve nga këto të ardhura?Realiteti tregon që jo. Mjafton të shikosh bulevardin, mjafton të shikosh rrugët e Elbasanit, shpopullimi që po i ndodh. Ne kemi dhe migrim dhe emigrim.Akoma dhe më keq.Ata të cilët nuk kanë mundësi apo nuk duan të shkojnë nga ky vend që ta tradhtojnë Shqipërinë dhe të ikin, shkojnë në Tiranë dhe ata të cilët nuk e duan fare Shqipërinë shkojnë jashtë këtij vendi. Kështu që ne po vuajmë të dyja këto gjëra. Komponenti tjetër, a kemi ajër më të pastër me këto të ardhura që na u shtuan? Shkoni te inceneratori, shikoni si menaxhohen mbetjet.A kemi ujë nëpër rubineta? 23 milion euro, Elbasanllit akoma nuk kanë ujë.Kanë 24 orë ujë ujë në muaj, jo në ditë siç u premtua. Prandaj mos bëni gabim të votoni këtë reformë. Ju nuk keni më legjitimit për të votuar asgjë, sepse faktet e fundit që dolën ditët e fundit dhe kjo ishte dhe ajo të cila unë nuk i bëja dot atë lidhjen dhe të më kapte llogjika se si ka mundësi që ju të godisni pikërisht zonat që janë votuesit e juaj, t'i mërzisni sepse do humbni vota. Po ju nuk e çani kokën fare sepse deputetët zgjidhjen tek kodra e kuajve. ndoshta shumë këshilltarë këtu dhe kryebashkiaku është zgjedhur diku tjetër në Elbasan që ju e dini të gjithë. Kështu që përderisa ju zgjidheni nga disa institucione kriminale dhe informale atëherë ju vazhdoni në këtë vazhdën e reformave për shpopullimin e këtij vendi. Mos u bëni pjesë e turpit sepse historia do na gjykojë të gjithëve. Këtu do jemi, do rrojmë e do shikojmë. Njeriu kur humb lirinë ka humbur gjithçka. Mos e humbni lirinë sot.E humbët kur i besuat Edi Ramës kthehuni, bëhuni Partia Socialiste, Partia Socialiste që pretendon që do jetë ajo.

Lutfi Lala – Kryetar i Këshillit Bashkiak Elbasan

Hapet votimi për dhënien e vendimit pro ose kundra.Shprehje vendimi pro ose kundra.Ky është vendimi I Këshillit.

Këshilli Bashkiak me 26 vota pro, 2- kundër, 0- abstenim, miraton sa më sipër.

V.K(B.Copja,M.Kaculi)

Mbajtëse e Proçesverbalit

Selena Gjorga

Kryetar i këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Sekretar I Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma